



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT

(Vetëm për mediat. Nuk është dokument zyrtar)

D H O M A E
A P E L I T

Hagë, 23 janari 2014

Përmbledhje e Aktgjykimit në çështjen Prokurori k. Shainoviqit dhe të tjerëve

Dhoma e Apelit është mbledhur sot, në përputhje me urdhrin për caktim date të 15 nëntorit 2013 dhe Rregullën 117(D) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit, për të shpallur vendimin e apelit në çështjen Prokurori kundër Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit, Nebojsa Pavkoviqit, Vladimir Llazareviqit dhe Sreten Llukiqit.

Në bazë të praktikës së Tribunalit, unë nuk do të lexoj tekstin e Aktgjykimit të Apelit, por vetëm vendimin, dhe do të bëj një përmbledhje të pikave kryesore të apelit dhe të përfundimeve thelbësore të Dhomës së Apelit. Kjo përmbledhje gojore nuk është pjesë e versionit zyrtar dhe autoritativ të aktgjykimit të Dhomës së Apelit që do t'u jepet palëve në formë të shkruar në përfundim të kësaj seance.

Në Aktgjykimin me shkrim, emrat e vendndodhjeve gjeografike të përmendura jepen në të dy versionet - si në shqip, po ashtu në gjuhën boshnjake/kroate/serbe. Thjesht për lehtësi, në përmbledhjen e sotme do të përdor vetëm emrat e vendeve në versionin boshnjak/kroat/serb.

Rrethanat e përgjithshme të çështjes

Kjo çështje lidhet me ngjarje që ndodhën midis marsit dhe qershorit 1999 dhe që kanë të bëjnë me zhvendosjen e dhunshme të popullatës shqiptare kosovare në Kosovë. Dhoma Gjyqësore konkludoi se pas fillimit të bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, kundër popullatës civile shqiptare kosovare filloi një fushatë dhune gjatë së cilës shumë shqiptarë kosovarë u zhvendosën me dhunë, ndodhën shumë vrasje dhe raste të dhunës seksuale dhe xhami të tëra u shkatërruan qëllimisht. Dhoma Gjyqësore konkludoi se, as bombardimet e NATO-s e as konflikti i atëhershëm i armatosur midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo "UÇK" dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë, apo "RFJ" dhe Serbisë nuk ishin shkaku kryesor i largimit të qindra mijëra shqiptarëve kosovarë. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishin pikërisht veprimet e qëllimshme të forcave të RFJ-së dhe Serbisë gjatë fushatës së dhunës që shkaktuan largimin e së paku 700.000 shqiptarëve kosovarë nga Kosova.

Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se "gjatë kohës së krimeve të pretenduara në Aktakuzë" ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale ose "NPK", qëllimi i përbashkët i së cilës ishte zhvendosja e dhunshme e popullatës shqiptare kosovare brenda dhe jashtë kufinjve të Kosovës përmes një fushate gjerësisht të përhapur dhe sistematike terrori dhe dhune. Dhoma Gjyqësore konkludoi se kjo u bë për të mundur vijimësinë e kontrollit të Kosovës prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se ndërsa krimet e dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme ishin pjesë e qëllimit të përbashkët, krimet e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe vrasjes dhe përndjekjes nëpërmjet vrasjeve, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të objekteve fetare si krime kundër njerëzimit, ishin jashtë synimit të përbashkët të NPK-së.

Gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, z. Shainoviq ishte zëvendëskryeministër i RFJ-së; z. Pavkoviq, komandant i Armatës së Tretë të Ushtrisë së Jugosllavisë ose "UJ"; z. Llazareviq komandant i Korpusit të Prishtinës të UJ-së, dhe z. Llukiq shef i Shtabit të

<http://www.icty.org>

Media Office/Communications Service

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31-70-512-8752; 512-5343; 512-5356 Fax: +31-70-512-5355

Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë në Prishtinë, i njohur gjithastu si "Shtabi i MPB-së". Të gjithëve të lartpërmendurve do t'u referohem me "Apeluesit".

Dhoma Gjyqësore konkludoi se z. Shainović, z. Pavković dhe z. Lukić ishin pjesëmarrës në NPK meqenëse të tre ata kishin synimin e përbashkët të zhvendosjes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare dhe kontribuan ndjeshëm në NPK. Lidhur me krimet jashtë qëllimit të përbashkët, Dhoma Gjyqësore konkludoi se kryerja e vrasjes dhe përndjekjes përmes vrasjeve dhe shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare ishin logjikisht të parashikuashme për z. Shainović, z. Pavković dhe z. Lukić. Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se kryerja e përndjekjes përmes dhunës seksuale ishte logjikisht e parashikueshme për z. Pavković, por jo edhe për z. Shainović dhe z. Lukić.

Dhoma Gjyqësore e shpalli z. Shainović fajtor për dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasje dhe përndjekje si krime kundër njerëzimit, dhe vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK. Ai u dënua me 22 vjet burgim.

Dhoma Gjyqësore e shpalli z. Pavković fajtor dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasje dhe përndjekje si krime kundër njerëzimit, dhe vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK. Ai u dënua me 22 vjet burgim.

Dhoma Gjyqësore e shpalli z. Lukić fajtor dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasje dhe përndjekje si krime kundër njerëzimit, dhe vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK. Ai u dënua me 22 vjet burgim.

Dhoma Gjyqësore e shpalli z. Lazarević fajtor për ndihmë dhe inkurajim të krimit të dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit në të cilat mori pjesë UJ-ja. Dhoma Gjyqësore e shpalli z. Lazarević të pafajshëm për ndihmë dhe inkurajim të vrasjes si krim kundër njerëzimit, vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, dhe përndjekjes përmes vrasjes si krim kundër njerëzimit. Ai u dënua me 15 vjet burgim.

Secili prej Apeluesve apeloj fajësinë e vet dhe dënimin. Zyra e Prokurorit (më tej Prokuroria), parashtroi gjashtë pika apeli kundër shpalljes së pafajësisë të secilit prej Apeluesve për disa akuza, si dhe në lidhje me dënimet e tyre.

Dhoma e Apelit dëgjoi parashtrimet gojore të palëve nga 11 deri më 15 mars 2013.

Tani do të shqyrtoj pretendimet e Apeluesve dhe të Prokurorisë, dhe fillimisht do të shqyrtoj parashtrimet lidhur me pretendimet për gabime në lidhje me gjykimin e drejtë.

Pretendimet për gabime lidhur me gjykim të drejtë

Z. Pavković dhe z. Lukić pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë për shkak të kohës së pamjaftueshme dhe mungesës së mjeteve të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre. Duke vlerësuar tërësisht administrimin e procesit prej Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit konkludon se z. Pavković dhe z. Lukić kishin kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjet e tyre. Në lidhje me kundërshtimet e tjera të z. Lukić, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk bëri gabime në nxjerrjen e vendimeve përkatëse dhe veproi pa kurrfarë paragjykimesh.

Pretendimet për gabime lidhur me Aktakuzën

Tani do të shqyrtoj parashtrimet e palëve në lidhje me pretendimet për gabime lidhur me Aktakuzën.

Z. Shainoviq argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor bazuar në rolin e tij si koordinator politik i forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, për arsye se kjo akuzë nuk është shtjelluar siç duhet në Aktakuzë. Dhoma e Apelit gjykon se termi "koordinator politik" në vetvete nuk përbën fakt juridikisht thelbësor që duhej të ishte shtjelluar në Aktakuzë dhe rrjedhimisht hedh poshtë apelin e z. Shainoviq në lidhje me këtë pikë.

Z. Llazareviq argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli përgjegjës për dëbim dhe zhvendosje të dhunshme të kryer në zonën e fshatit Qirez, në komunën e Skënderajt, duke u bazuar në veprime që ndodhën jashtë kuadrit kohor të Aktakuzës. Dhoma e Apelit gjykon se kuadri kohor i përcaktuar në pikën c të paragrafit 72 të Aktakuzës, kur lexohet së bashku me akuzat e parashtruara në pjesën e përgjithshme të të njëjtit paragraf, është tregues i mjaftueshëm i kohës së veprimeve. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Aktakuza e informon në masën e duhur z. Llazareviq për datat e krimeve që i ngarkohen, dhe rrjedhimisht hedh poshtë pjesën e apelit e tij që pretendon mangësi të Aktakuzës në këtë drejtim.

Z. Llukiq argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli përgjegjës për vrasjen e viktimave emrat e të cilëve nuk figurojnë në Aktakuzë. Pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve, Dhoma e Apelit konkludon se vetëm katër viktima të vrasjes që përmend z. Llukiq nuk janë përmendur me emër dhe mbiemër në Shtojcat e Aktakuzës. Duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, përfshirë dhe numrin e madh të viktimave të pretenduara, largësinë fizike të z. Llukiq nga vetë vrasjet dhe faktin se Shtojcat e Aktakuzës nuk paraqesin listë të plotë të viktimave, Dhoma e Apelit gjykon se mospërfshirja e emrave të viktimave nuk përbën mangësi të Aktakuzës dhe rrjedhimisht hedh poshtë këtë pjesë të apelit të z. Llukiq.

Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur konkludoi se dëbimet dhe zhvendosjet e dhunshme të parashtruara me hollësi në paragrafin 72 të Aktakuzës nuk u akuzuan si forma të përndjekjes brenda Pikës 5. Dhoma e Apelit gjykon se Prokuroria nuk ka paraqitur kundërshtim ndaj një interpretimi të tillë të Aktakuzës prej Dhomës Gjoqësore, kur pati mundësi të arsyeshme për ta bërë këtë. Dhoma e Apelit më tej konkludon se Prokuroria ka humbur të drejtën për t'a ngritur këtë argument në apel dhe rrjedhimisht hedh poshtë këtë pjesë të apelit të Prokurorisë.

Dhoma e Apelit vëren se krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) të kryera në Tushilë, në komunën e Skënderajt, më 29 mars 1999, nuk u përfshinë në Aktakuzë. Dhoma e Apelit konkludon se kjo mospërfshirje që pati për pasojë mosinformimin e Apeluesve paragjykoj dhe dëmtoi thelbësisht Apeluesit në përgatitjen e mbrojtjeve të tyre. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit shfuqizon fajësinë e z. Shainoviq, z. Pavkoviq, z. Llazareviq dhe z. Llukiq, për ngjarjet në Tushilë më 29 mars 1999.

Pretendime për gabime lidhur me synimin kriminal si kusht ombrellë i Nenit 5 të Statutit

Z. Pavkoviq parashtron një sërë kundërshtimesh lidhur me përfundimet e Dhomës Gjyqësore për synimin kriminal si kusht ombrellë për krime kundër njerëzimit. Dhoma e Apelit gjykon se për vërtetimin e synimit kriminal si kusht ombrellë i Nenit 5 të Statutit të Tribunalit, i akuzuari duhet të ketë pasur dijeni për sulmin kundër popullatës civile dhe veprimet e tij duhet të kenë qenë pjesë e atij sulmi, ose të paktën ai duhet të ketë marrë rrezikun se veprimet e tij ishin pjesë e sulmit. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit nuk konstaton asnjë gabim ligjor në përfundimet përkatëse të Dhomës Gjyqësore. Rrjedhimisht, Dhoma hedh poshtë këtë pjesë të apelit të z. Pavkoviq.

Shkeljet bazë

Në të 13 komunat ku pretendohet se u kryen krimet e akuzuara në Aktakuzë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjatë pranverës së vitit 1999, forca të RFJ-së dhe Serbisë qëllimisht

dhe dhunshëm zhvendosën civilë shqiptarë kosovarë brenda dhe jashtë kufijve të Kosovës. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se gjatë zhvendosjes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare, forcat e RFJ-së dhe Serbisë vranë të paktën 600 vetë, shkatërruan ose dëmtuan xhami, dhe ushtruan dhunë seksuale kundër femrave shqiptare kosovare.

Z. Llazareviq dhe z. Llukiq kundërshtojnë përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me zhvendosjen e dhunshme prej forcave të RFJ-së dhe Serbisë. Dhoma e Apelit gjykon se me përjashtim të dy vendndodhjeve, z. Llazareviq dhe z. Llukiq nuk arritën të provonin ndonjë gabim në përfundimet e Dhomës Gjyqësore. Vetëm në lidhje me qytetin e Kaçanikut dhe Turiqecin Dhoma e Apelit konkludon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se i vetmi deduksion logjik që mund të nxirrej ishte se pjesëtarë të forcave të UJ-së në lidhje me qytetin e Kaçanikut, dhe të UJ-së dhe MPB-së në lidhje me Turiqecin, shkaktuan zhvendosjen e popullatës. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton argumentin e z. Llazareviq dhe shfuqizon fajësinë e tij në lidhje me incidentin në qytetin e Kaçanikut. Dhoma e Apelit gjithashtu shfuqizon fajësinë e z. Shainoviq, z. Pavkoviq, z. Llazareviq dhe z. Llukiq në lidhje me incidentin e Turiqecit.

Prokuroria ka apeluar verdiktin e pafajësisë së z. Llazareviq prej Dhomës Gjyqësore për z. Llazareviq në lidhje me disa fshatra në tri komuna. Në këtë drejtim, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi duke mos zbatuar përfundimet e veta se UJ-ja mori pjesë në dëbimin dhe zhvendosjen e dhunshme nga këto vende, si krime kundër njerëzimit.

Në Vëllimin 2 të Aktgjykimit, Dhoma Gjyqësore konkludoi se shqiptarë kosovarë nga fshatra të komunës së Mitrovicës, Prizrenit dhe Ferizajt, u zhvendosën me dhunë prej forcave të MPB-së dhe UJ-së. Mirëpo, në Vëllimin 3 të Aktgjykimit, Dhoma Gjyqësore nuk e shpalli z. Llazareviq përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim të krimeve të zhvendosjes së dhunshme nga këto vende, duke theksuar se këto krime i kishte kryer MPB-ja, pa pjesëmarrjen e UJ-së. Duke rikujtuar se aktgjykimi duhet lexuar si një i tërë, Dhoma e Apelit konkludon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore në Vëllimin 3 është një gabim dhe rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore gaboi duke mos e zbatuar përfundimin e vet faktik se UJ-ja mori pjesë në kryerjen e krimeve. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht apelin e Prokurorisë. Gjithsesi, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatëses Ramaroson, refuzon të japë verdikt të ri fajësie.

Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se forcat e UJ-së dhe MPB-së vranë gjithsej të paktën 600 vetë gjatë operacioneve të tyre për zhvendosjen e dhunshme të popullatës civile shqiptare kosovare. Z. Llukiq parashtron disa kundërshtime ndaj përfundimeve të Dhomës Gjyqësore në lidhje me këto vrasje, duke përfshirë dhe identifikimin e viktimave dhe shkakun e vdekjes së tyre.

Dhoma e Apelit i konsideron me vend vetëm argumentet e Z. Llukiq në lidhje me vrasjet e kryera gjatë operacionit në luginën e Carragojit, në komunën e Gjakovës. Në veçanti, z. Llukiq argumenton se disa prej 287 viktimave për të cilat Dhoma Gjyqësore konkludoi se u vranë gjatë operacionit në luginën e Carragojit, mund të kenë qenë pjesëmarrës në luftime. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk përcaktoi nëse në kohën e vdekjes së tyre viktimat ishin civilë që nuk merrnin pjesë aktive në luftime apo luftëtarë jashtë luftimit. Dhoma e Apelit gjykon se në mungesë të provave të mjaftueshme në lidhje me rrethanat dhe statusin e çdo viktime, Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se të 287 vrasjet e kryera gjatë operacionit në luginën e Carragojit përbënin vrasje si krim kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Pasi shqyrtoi provat përkatëse, Dhoma e Apelit u bind se vetëm për 13 nga të vrarët është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk merrnin pjesë aktive në luftime ose ishin luftëtarë jashtë luftimeve në kohën e vdekjes së tyre. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit shfuqizon fajësinë e z. Pavkoviq dhe z. Llukiq për vrasje sipas Nenit 3 dhe 5 të Statutit të Tribunalit në lidhje me 274 prej 287 shqiptarëve kosovarë për të cilët Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishin vrarë. Dhoma e Apelit hedh poshtë kundërshtimet e tjera të z. Llukiq në lidhje me përfundimet e Dhomës Gjyqësore për vrasje.

Për sa u përket përfundimeve të Dhomës Gjyqësore mbi kryerjen e dhunës seksuale, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se përdhunimet e K31-shit, K14-ës dhe K62-shit në Prishtinë u kryen me synim diskriminues dhe rrjedhimisht përbënin përndjekje. Pavarësisht nga përfundimi se gjatë operacionit të largimit të një numri të madh shqiptarësh kosovarë nga qyteti i Prishtinës, forcat e UJ-së dhe MPB-së kryen përdhunime, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë që do të provonte ekzistencën e synimit diskriminues të autorëve të përdhunimeve. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk mori siç duhet parasysh kontekstin në të cilën ndodhën përdhunimet dhe gaboi kur konkludoi se nuk kishte prova nga të cilat mund të deduktohej synimi diskriminues i keqbërësve. Dhoma e Apelit është e bindur se përfundimi i vetëm i arsyeshëm që mund të nxirret nga provat e paraqitura në gjyq është se K31-shi, K14-a, dhe K62-shi u përdhuan me synim diskriminues nga pjesëtarë të UJ-së dhe MPB-së dhe se veprime të tilla përbëjnë përndjekje si krim kundër njerëzimit. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht këtë pikë të apelit të Prokurorisë.

Ndërmarrja e përbashkët kriminale

Tani do të shtjelloj parashtrimet e z. Shainoviq, z. Pavković dhe z. Llukiq në lidhje me përgjegjësinë e tyre individuale penale në bazë të përgjegjësisë sipas NPK-së. Së pari do të shtjelloj kundërshtimet e tyre në lidhje me qëllimin e përbashkët të NPK-së dhe më pas argumentet e tyre në lidhje me pjesëmarrjen në NPK.

Ekzistenca e një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët

Z. Shainoviq, z. Pavković dhe z. Llukiq parashtrojnë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ekzistonte një qëllim i përbashkët i pjesëtarëve të NPK-së gjatë kohës së krimeve të akuzuara në Aktakuzë i cili përbënte ose përfshinte kryerjen e krimeve të përcaktuara në Statut, dhe se ky qëllim i përbashkët synonte zhvendosjen e dhunshme të shumë shqiptarëve kosovarë brenda dhe jashtë kufijve të Kosovës.

Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore nxori përfundime mbi kryerje të krimeve të përmendura në Aktakuzë në lidhje me ngjarjet që ndodhën prej 24 marsit e deri në fund të majit 1999. Për këtë arsye, për mendimin e Dhomës së Apelit konkluzioni i Dhomës Gjyqësore mbi ekzistencën e qëllimit të përbashkët ka të bëjë me periudhën kur ndodhën krimet, domethënë nga 24 marsi e deri në fund të majit 1999.

Dhoma e Apelit kujton se ndonëse Dhoma Gjyqësore nxori përfundimet lidhur me ekzistencën e qëllimit të përbashkët duke u bazuar në disa faktorë, ajo i kushtoi rëndësi më të madhe praktikës së shpërguljeve të dhunshme të shqiptarëve kosovarë dhe konfiskimit të dokumenteve të tyre të identifikimit. Z. Shainoviq, z. Pavković dhe z. Llukiq nuk mundën të provonin se Dhoma Gjyqësore gaboi gjatë vlerësimit të provave lidhur me këta dy faktorë. Dhoma e Apelit konkludon se provat në lidhje me këta dy faktorë janë në fakt të mjaftueshme që një gjykes i arsyeshëm faktesh të arrijë në përfundimin se konkluzioni i vetëm i arsyeshëm është se ekzistonte një qëllim i përbashkët ashtu siç konkludoi Dhoma Gjyqësore. Dhoma e Apelit hedh poshtë tërësisht argumentet e z. Shainoviq, z. Pavković dhe z. Llukiq në lidhje me përfundimet e Dhomës për ekzistencën e qëllimit të përbashkët.

Ekzistenca dhe pushteti i Komandës së Përbashkët

Tani do të shtjelloj parashtrimet e z. Shainoviq, z. Pavković dhe z. Llukiq në lidhje me organin e njohur si "Komanda e Përbashkët për Kosovë dhe Metohi" ose thjeshtë "Komanda e Përbashkët".

Dhoma Gjyqësore konkludoi se organi i njohur si Komanda e Përbashkët e përbërë nga politikanë dhe pjesëtarë të UJ-së dhe MPB-së u krijua rreth qershorit 1998, dhe se kishte ndikim mbi forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë dhe luajti rol në koordinimin e këtyre forcave në gjysmën e dytë të 1998 dhe gjysmën e parë të 1999. Në nxjerrjen e

përfundimeve në lidhje me synimin dhe kontributin e z. Shainoviq, z. Pavkoviq dhe z. Llukiq në realizimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi rolet e tyre në koordinimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së përmes Komandës së Përbashkët. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se z. Shainoviq, z. Pavkoviq dhe z. Llukiq nuk provuan asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore në përfundimet e saj mbi ekzistencën dhe pushtetin e Komandës së Përbashkët. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, hedh poshtë parashtrimet lidhur me këtë pikë.

Pjesëmarrja e z. Shainoviq në NPK

Tani do të analizoj argumentet e z. Shainoviq që kundërshtojnë përfundimet e Dhomës Gjyqësore se ai kontribuoi ndjeshëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së dhe kishte të njëjtin synim të zhvendosjes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare.

Gjatë analizimit të pjesëmarrjes së z. Shainoviq në NPK, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai kishte pushtet të gjerë *de facto* mbi forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë dhe ishte hallka kryesore kryesore midis Presidentit të atëhershëm të RFJ-së, Slobodan Millosheviqit, i cili ishte në Beograd, dhe njësitë të UJ-së dhe MPB-së që vepronin në Kosovë. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se z. Shainoviq luajti rolin e koordinatorit politik të forcave në Kosovë.

Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se z. Shainoviq nuk vërtetoi asnjë gabim në përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ai ishte njëri prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë dhe më të besueshëm të Slobodan Millosheviqit në vitin 1999. Dhoma e Apelit më tej gjykon se z. Shainoviq nuk provoi asnjë gabim në përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me rolin e tij udhëheqës gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët në vitin 1998, pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e mbajtura më 1998 ku u diskutua Plani për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë, pozitën e tij si Kryetarit i Komisionit për Bashkëpunim me Misionin Verifikues për Kosovën, marrëdhëniet e tij me Ibrahim Rugovën, si dhe pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e Shtabit të MBP-së të datës 4 prill 1999. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, më tej konkludon se z. Shainoviq nuk provoi asnjë gabim në përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me takimin e tij me Millosheviqin më 4 maj 1999, mbledhjen në Shtabin e MPB-së më 7 maj 1999 dhe mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 1 qershor 1999. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjithashtu hedh poshtë argumentet e z. Shainoviq në lidhje me rolin e tij ndërlihdës dhe ndikues tek forcat e UJ-së dhe MPB-së. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykon se z. Shainoviq nuk provoi asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore në nxjerrjen e përfundimit se ai kishte mundësi të jepte propozime, sugjerime dhe udhëzime.

Megjithëse gjykon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në praninë e z. Shainoviq në takimin me Zilatomir Peshiqin më 13 prill 1999, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se gabimi i Dhomës Gjyqësore nuk ndikon në konkluzionin e saj se gjatë 1999, z. Shainoviq vazhdoi të ishte ndërlihdësi midis UJ-së dhe MPB-së, nga njëra anë, dhe Millosheviqit, nga ana tjetër.

Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se z. Shainoviq nuk mundi të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai luajti rolin e koordinatorit politik të UJ-së dhe MPB-së gjatë viteve 1998 dhe 1999 dhe se kontribuoi ndjeshëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët.

Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se z. Shainoviq ishte në dijeni të zhvendosjeve dhe krimeve që po ndodhnin në Kosovë në 1998, dhe se ai vazhdoi të merrte informacion për kryerje krimesh, duke përfshirë zhvendosjet e dhunshme, gjatë gjithë vitit 1999. Dhoma e Apelit gjykon se një gjykues i arsyeshëm faktesh do të nxirrte përfundimin se z. Shainoviq

kishte të njëjtin synim për zhvendosjen e dhunshme të një pjese të popullatës shqiptare kosovare në vitin 1999. Në lidhje me këtë pikë, Dhoma e Apelit lë në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se deklaratat e z. Shainoviq për parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve ishin thjeshtë "sa për sy e faqe".

Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, lë në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se z. Shainoviq mori pjesë në NPK.

Më tej z. Shainoviq kundërshton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ai ishte përgjegjës për krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe vrasjes dhe përndjekjes përmes vrasjeve, dhunës seksuale dhe shkatërrimit apo dëmtimit të objekteve fetare si krime kundër njerëzimit sipas kategorisë III të NPK-së. Dhoma e Apelit konkludon se në nxjerrjen e përfundimit të saj, Dhoma Gjyqësore zbatoi gabimisht një shkallë më të lartë të parashikueshmërisë se sa kërkohet prej standardit të duhur ligjor. Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon se kur gjatë shqyrtimit nëse vrasja ishte e parashikueshme për z. Shainoviq, Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai kishte dijeni për kryerjen e vrasjeve në disa vende.

Duke marrë parasysh përfundimet e tjera faktike të Dhomës Gjyqësore dhe duke zbatuar standardin e duhur ligjor, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Liu, gjithsesi është bindur se duke filluar prej 7 majit 1999, për z. Shainoviq ishte e parashikueshme se mund të kryeshin vrasje dhe se ai e morri këtë rrezik me dashje. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht apelin e z. Shainoviq dhe shfuqizon fajësinë e tij për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, dhe vrasje dhe përndjekje përmes vrasjeve si krime kundër njerëzimit, të kryera para 7 majit 1999 sipas kategorisë III të NPK-së. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Liu, lë në fuqi fajësinë e z. Shainoviq për vrasje (si shkelje e e ligjeve ose zakoneve të luftës, dhe vrasje dhe përndjekje përmes vrasjeve si krime kundër njerëzimit), të kryera në Dubravë rreth 25 majit 1999 sipas kategorisë III të NPK-së. Dhoma e Apelit më tej konkludon se z. Shainoviq nuk vërtetoi asnjë gabim në përfundimet faktike mbi të cilat u mbështet Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se ishte e parashikueshme për z. Shainoviq se do të kryej përndjekje përmes shkatërrimit apo dëmtimit të objekteve fetare, dhe se ai e mori këtë rrezik me dashje. Duke qenë se është vërtetuar një shkallë më e lartë parashikueshmërie, vetvetiu vërtetohet edhe parashikueshmëria në një shkallë më të ulët. Rrjedhimisht argumentet e z. Shainoviq hidhen poshtë.

Pjesëmarrja e z. Pavkoviç në NPK

Tani do të shtjelloj argumentet e z. Pavkoviç që kundërshtojnë përfundimet e Dhomës Gjyqësore se ai kontribuoi ndjeshëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së dhe kishte të njëjtin synim të zhvendosjes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare. Ai gjithashtu kundërshton përfundimet e Dhomës Gjyqësore se ai është fajtor si për krimet e UJ-së, po ashtu edhe të MPB-së.

Në nxjerrjen e përfundimeve të veta, Dhoma Gjyqësore mori parasysh se gjatë gjithë periudhës së kryerjes së krimeve, z. Pavkoviç, ndër të tjera, urdhëroi dhe mbështeti operacionet e UJ-së në Kosovë, duke përfshirë operacionet e përbashkëta me MPB-në, mobilizoi forcat dhe i komandoi gjatë këtyre operacioneve. Dhoma Gjyqësore gjithashtu gjykoj se z. Pavkoviç kontribuoi në krijimin dhe vijimësinë e atmosferës së mosndëshkimit duke mos i raportuar në masën e duhur krimet e kryera prej forcave nën kontrollin e tij dhe duke mos marrë masat e nevojshme pasi informohej për to, gjë që inkurajoi kryerjen e krimeve prej forcave që ishin nën kontrollin e pjesëtarëve të NPK-së. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore mori parasysh bashkëpunimin e ngushtë të z. Pavkoviç me Sllobodan Millosheviqin në vitet 1998 dhe 1999, faktor që i mundësoi atij të anashkalonte hierarkinë komanduese të UJ-së. Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se z. Pavkoviç ishte në dijeni të krimeve që kryen pjesëtarët e UJ-së dhe MPB-së dhe të pretendimeve për krime të tilla në vitet 1998 dhe 1999.

Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se z. Pavković kontribuoi në NPK para ekzistencës së qëllimit të përbashkët përmes përfshirjes së tij në procesin e armatosjes së popullatës joshqiptare dhe çarmatosjes së popullatës shqiptare të Kosovës dhe dislokimit të forcave shtesë të UJ-së në Kosovë në kundërshtim me marrëveshjet e tetorit të 1998. Megjithatë, Dhoma e Apelit gjykon se këto gabime nuk ndikojnë në konkluzionin e përgjithshëm të Dhomës Gjyqësore se z. Pavković kontribuoi ndjeshëm në NPK meqenëse konkluzionin e vet Dhoma Gjyqësore e mbështeti në prova të tjera të shumta, duke përfshirë edhe sjelljet e tjera të Pavkovićit të cilat vazhduan gjatë gjithë vitit 1999.

Argumentet e tjera të z. Pavković nuk provojnë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai kontribuoi ndjeshëm në qëllimin e përbashkët të NPK-së dhe kishte të njëjtin synim të zhvendosjes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare. Për këtë arsye, parashtrimet e tij rreth kësaj pike hidhen poshtë. Për më tepër, z. Pavković nuk arriti të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se z. Pavković është fajtor si për krimet e kryera prej forcave të UJ-së, po ashtu edhe për ato të kryera prej MPB-së, bazuar në kategorinë I të NPK-së. Argumentet e tij lidhur me këtë pikë gjithashtu hidhen poshtë.

Rrjedhimisht Dhoma e Apelit lë në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se z. Pavković ishte pjesëtar i NPK-së.

Z. Pavković më tej kundërshton konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se ai ishte përgjegjës për krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, dhe vrasjes dhe përndjekjes përmes vrasjeve, dhunës seksuale dhe shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare si krime kundër njerëzimit sipas kategorisë III të NPK-së.

Siç është përmendur më lart në lidhje me z. Shainović, Dhoma e Apelit gjykon se në nxjerrjen e përfundimeve për kategorinë III të NPK-së, Dhoma Gjyqësore zbatoi gabimisht një shkallë më të lartë të parashikueshmërisë se sa kërkohet sipas standardit të duhur ligjor. Dhoma e Apelit gjykon se z. Pavković nuk arriti të provonte ndonjë gabim në përfundimet faktike mbi të cilat u mbështet Dhoma Gjyqësore kur nxorri përfundimet e saj lidhur me parashikueshmërinë prej tij të krimeve në fjalë dhe rrezikun që mori ai. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se gabimi ligjor i Dhomës Gjyqësore për sa i përket shkallës së parashikueshmërisë nuk ndikon në fajësinë e z. Pavković. Duke qenë se është vërtetuar një shkallë më e lartë parashikueshmërie, vetvetiu vërtetohet edhe parashikueshmëria në një shkallë më të ulët. Edhe argumentet e tjera të z. Pavković nuk vërtetojnë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai ishte fajtor për krimet që ishin jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentet e z. Pavković lidhur me përgjegjësinë e tij sipas kategorisë III NPK-së.

Pjesëmarrja e z. Llukiq në NPK

Më tej do të shqyrtoj argumentet e z. Llukiq kundër përfundimeve të Dhomës Gjyqësore në lidhje me rolin e tij si kreu i Shtabit të MPB-së, pjesëmarrjen e tij në NPK dhe kontributin e tij në jetësimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së dhe synimin e tij të përbashkët me të tjerët për shpërnguljen e dhunshme të popullatës shqiptare kosovare.

Dhoma Gjyqësore konkludoi se z. Llukiq dha një kontribut të konsiderueshëm në NPK duke qenë se ai ishte komandanti *de facto* i forcave të MPB-së të dislokuara në Kosovë nga mesi i vitit 1998 deri në mesin e vitit 1999, "hallka lidhëse" midis vendimmarrësve në Beograd dhe njerëzve në terren në Kosovë dhe u përfshi drejtpërsëdrejti në planifikim dhe në realizimin e operacioneve ditore të forcave të ndryshme të MPB-së në përputhje me planet e lartpërmendura.

Dhoma e Apelit e gjykon të gabuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore se z. Llukiq kontribuoi në NPK *para* ekzistencës së qëllimit të përbashkët, nëpërmjet implikimit të tij në procesin e armatosjes së popullatës joshqiptare dhe çarmatosjes së popullatës shqiptare kosovare. Gjithsesi, Dhoma e Apelit mendon se ky gabim nuk ndikon në konkluzionin e

Dhomës Gjyqësore se z. Llukiq dha kontribut të konsiderueshëm në NPK për arsye se ky konkluzion u mbështet në një numër të madh provash të tjera, përfshirë veprimet e z. Llukiq si kreu i Shtabit të MPB-së gjatë vitit 1999. Dhoma e Apelit konkludon se z. Llukiq nuk ka arritur të provojë se përfundimet e tjera të Dhomës Gjyqësore mbi pushtetin e Shtabit të MPB-së, rolin e tij si kreu i Shtabit të MPB-së dhe kontributin e tij në NPK, janë të gabuara.

Në nxjerrjen e përfundimit të synimit të përbashkët të z. Llukiq me anëtarë të tjerë të NPK-së për shpërnguljen e dhunshme të popullatës shqiptare kosovare, ndër të tjera Dhoma Gjyqësore mori parasysh informacionin e marrë nga z. Llukiq në vitin 1998 dhe 1999. Duke u kushtuar rëndësinë e duhur përfundimeve të Dhomës Gjyqësore mbi dijeninë e Llukiqit për akuzat e rënda për veprime kriminale të forcave të ndryshme në Kosovë nga mesi deri në fund të vitit 1998, dhe informacionin që ai mori për kryerjen e krimeve dhe largimin masiv të popullatës civile më 1999, Dhoma e Apelit e gjykon të arsyeshëm përfundimin e Dhomës Gjyqësore mbi dijeninë e z. Llukiq të krimeve, përfundim i bazuar në tërësinë e provave. Argumentet e tjera të apelit të z. Llukiq kundër përfundimeve të Dhomës Gjyqësore në lidhje me synimin e tij të përbashkët me të tjerët për shpërnguljen e dhunshme të një pjese të popullatës shqiptare kosovare, hidhen poshtë.

Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit lë në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se z. Llukiq mori pjesë në NPK.

Gjithashtu z. Llukiq apelon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se bazuar në kategorinë III të NPK-së ai është përgjegjës për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe për vrasje dhe përndjekje nëpërmjet vrasjes dhe shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare, si krime kundër njerëzimit. Ashtu sikurse u tha në lidhje me z. Shainoviq dhe z. Pavkoviç, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi me përdorimin e një standardi ligjor më të rreptë sesa standardi i duhur ligjor lidhur me parashikueshmërinë. Gjithashtu Dhoma e Apelit konkludon se gjatë analizës nëse vrasjet ishin të parashikueshme për z. Llukiq, Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në informacionin e marrë nga ai në lidhje me incidentin në Abrinë e Epërme.

Duke marrë parasysh përfundimet e tjera të Dhomës Gjyqësore dhe duke përdorur standardin e duhur ligjor, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht pikën e apelit të z. Llukiq lidhur me përgjegjësinë e tij për vrasje bazuar në kategorinë III të NPK-së dhe shfuqizon fajësinë e tij për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe vrasje dhe përndjekje nëpërmjet vrasjes si krime kundër njerëzimit kryer para ose më 1 prill 1999 bazuar në kategorinë III të NPK-së. Dhoma e Apelit lë në fuqi fajësinë e z. Llukiq për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe vrasje dhe përndjekje nëpërmjet vrasjes si krime kundër njerëzimit, të kryera në Korenicë dhe Mejë më 27 prill 1999, afër Studimes së Epërme në lidhje me kolonën më 2 dhe 3 maj 1999, dhe në Dubravë rreth 25 majit 1999, kategorinë III të NPK-së. Gjithashtu Dhoma e Apelit konkludon se z. Llukiq nuk ka arritur të provojë se përfundimi i Dhomës Gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë e tij sipas kategorisë III të NPK-së për shkatërrimin ose dëmtimin e objekteve fetare, është i gabuar. Duke qenë se bazuar në përfundimet faktike të Dhomës Gjyqësore vërtetohet një shkallë më e lartë parashikueshmërie, vetvetiu vërtetohet edhe parashikueshmëria në një shkallë më të ulët.

Apeli i Prokurorisë në lidhje me kategorinë III të NPK-së

Tani i vjen radha apelit të Prokurorisë lidhur me lirimin prej akuzave të z. Shainoviq dhe z. Llukiq për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, kryer në Beleg, Qirez dhe Prishtinë bazuar në përgjegjësinë e kategorisë III të NPK-së dhe lirimit prej akuzave të z. Pavkoviç për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale të kryer në Prishtinë bazuar në kategorinë III të NPK-së.

Në lidhje me z. Shainoviq dhe z. Llukiq, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor duke zbatuar standardin jo të duhur ligjor lidhur me synimin kriminal të kategorisë III të NPK-së. Prokuroria i kërkon Dhomës së Apelit që të zbatojë standardin e

duhur ligjor në lidhje me faktet e çështjes dhe të fajësojë z. Shainoviq dhe z. Llukiq për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale. Lidhur me z. Pavkoviç, Prokuroria parashtron se Dhoma e Apelit duhet ta shpallë fajtor për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale të kryer në Prishtinë bazuar në kategorinë III të NPK-së.

Sikurse u shpjegua në lidhje me apelet e z. Shainoviq, z. Pavkoviç dhe z. Llukiq, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur konkludoi se që i akuzuari të ngarkohet me përgjegjësi sipas kategorisë III të NPK-së, duhet që për të akuzuarin të jetë e parashikueshme se krimi "do të kryhej". Standardi i duhur ligjor për synimin kriminal të kategorisë III të NPK-së dikton se për të akuzuarin duhet të ketë qenë e parashikueshme që një krim i tillë mund të kryhej nga një anëtar i NPK-së ose nga një apo më shumë persona të përdorur nga cilido anëtar i NPK-së me synim kryerjen e veprimit të fajshëm të krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët, dhe që i akuzuari ka marrë përsipër me dashje rrezikun e kryerjes së një krimi të tillë nëpërmjet pjesëmarrjes ose vijimësisë së pjesëmarrjes së tij në NPK. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore ka zbatuar standardin e duhur ligjor për synimin kriminal të kategorisë III të NPK-së në lidhje me provat e administruara. Në lidhje me z. Shainoviq, me përjashtim të mospajtit të gjykatësit Liu, Dhoma e Apelit konkludon se për të ishte e parashikueshme se mund të ndodhte përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale në Beleg, Qirez dhe Prishtinë dhe se ai e mori përsipër këtë rrezik me dashje. Në lidhje me z. Llukiq, Dhoma e Apelit gjykon se për të ishte e parashikueshme se mund të ndodhte përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale në Beleg, Qirez dhe Prishtinë dhe se ai e mori përsipër këtë rrezik me dashje. Në lidhje me z. Pavkoviç, Dhoma e Apelit gjykon se për të ishte e parashikueshme se mund të ndodhte përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale në Prishtinë dhe se ai e mori përsipër këtë rrezik me dashje.

Rrjedhimisht Dhoma e Apelit miraton apelin e Prokurorisë në pjesën përkatëse dhe me përjashtim të mospajtit të gjykatësit Liu në lidhje me z. Shainoviq, konkludon se Dhoma Gjyqësore gabo i shpalli z. Shainoviq dhe z. Llukiq fajtorë për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, si krim kundër njerëzimit në Beleg, Qirez dhe Prishtinë. Gjithashtu, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gabo i shpalli z. Pavkoviç fajtor për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, si krim kundër njerëzimit në Prishtinë. Gjithsesi, me përjashtim të mospajtit të gjykatëses Ramaroson, Dhoma e Apelit nuk do japë verdikt të ri fajësie.

Ndihmë dhe Inkurajim

Fajësia e z. Llazareviq për Ndihmë dhe Inkurajim

Tani do të shqyrtoj argumentet e apelit të z. Llazareviq kundër përfundimeve të Dhomës Gjyqësore se ai kishte synimin e nevojshëm kriminal dhe kreu krimin e ndihmës dhe inkurajimit në dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).

Duke iu referuar Aktgjykimit të Apelit në çështjen *Perishiq*, z. Llazareviq parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim duke mos mundur të përcaktonte nëse veprimet apo mosveprimet e tij synonin konkretisht të ndihmonin në dëbimin dhe zhvendosjen e dhunshme dhe rrjedhimisht doli në konkluzionin e gabuar se ai ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e këtyre krimeve.

Dhoma e Apelit nuk pajtohet me konkluzionin në Aktgjykimin e Apelit *Perishiq* se Aktgjykimet e Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin* dhe *Llukiq e Llukiq* konfirmojnë se konkretësia se kundër kujt u kryen veprimet është element i veprimit të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit. Për arsyt e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit gjykon se Aktgjykimet e Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin* dhe *Llukiq e Llukiq*, nga njëra anë dhe Aktgjykimi i Apelit *Perishiq* në anën tjetër ndryshojnë në pikën nëse kahu konkret është element i veprimit të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit. Dhoma e Apelit kujton se në rast se përballet me vendime të mëparshme kundërthënëse, ka detyrim të përcaktojë cilit vendim do t'i përmbahet ose nëse për arsye të forta do t'i anashkalojë të dy vendimet për hir të interesave të drejtësisë. Për shkak të kësaj mospërputhjeje në këto aktgjykime,

Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Tuzmukhamedov, do të përcaktojë qëndrimin e duhur.

Për këtë qëllim, Dhoma e Apelit ka shqyrtuar me kujdes jurisprudencën e Tribunalit dhe të TPNR-së si edhe të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit, Tuzmukhamedov konkludon se "kahu konkret" nuk është element i ndihmës dhe inkurajimit. Si rrjedhojë Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Tuzmukhamedov, hedh poshtë konkluzionin në Aktgjykimin e Apelit *Perishiq* për arsye se është në kundërshtim të drejtpërdrejtë dhe juridikisht thelbësor me jurisprudencën mbizotëruese në lidhje me veprimin e fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit dhe me të drejtën zakonore ndërkombëtare për këtë aspekt.

Duke u bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se në shqyrtimin e veprimit të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit, Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar të përcaktonte nëse veprimet e z. Llazareviq synonin konkretisht të ndihmonin dhe inkurajonin ose mbështesnin moralisht kryerjen e krimeve nga UJ-ja. Rrjedhimisht, kundërgargumentet e tij hidhen poshtë.

Gjithashtu Z. Llazareviq parashtroi se Dhoma Gjyqësore nxori përfundim të gabuar se ai u dha praktikisht ndihmë, inkurajim dhe mbështetje morale forcave të UJ-së të angazhuara në shpërnguljen e dhunshme dhe se sjellja e tij kontribuoi thelbësisht në kryerjen e krimeve. Së pari, ai apelon përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me implikimin dhe pjesëmarrjen e tij në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së në Kosovë, më 1999. Dhoma e Apelit gjykon se gjatë analizimit të sjelljes së Llazareviqit, Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në faktin se më 7 shkurt 1999, ai lëshoi urdhrin *Grom 3* për njësitë e Korpusit të Prishtinës, për arsye se në kohën e nxjerrjes së këtij urdhri ai nuk kishte synimin përkatës kriminal. Sidoqoftë, bazuar në provat e tjera të shfrytëzuara nga Dhoma Gjyqësore, Dhoma e Apelit gjykon se ky gabim nuk e çënon konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi pjesëmarrjen e z. Llazareviq në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta në Kosovë.

Po ashtu, z. Llazareviq kundërshton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ai nuk mori masa të mjaftueshme për të mundësuar hetimin e duhur të krimeve të rënda të kryera nga UJ-ja dhe nëpërmjet këtij mosveprimi ndihmoi dhe inkurajoi shpërnguljen e dhunshme të kryer nga forcat e UJ-së. Dhoma e Apelit gjykon se ndonëse mosmarrja e masa hetimore dhe ndëshkimore nga z. Llazareviq kundër kryerjes së shpërnguljes së dhunshme mund të ketë ndikuar në aftësinë e prokurorëve ushtarë për procedimin penal të autorëve, ky fakt në vetvete nuk është mjaftueshëm bindës për vërtetimin e përgjegjësisë së ndihmës dhe inkurajimit. Në fakt, për vërtetimin e veprimit të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit duhet provuar se një mosveprim i tillë kontribuoi thelbësisht në vijimësinë e kryerjes së shpërnguljes së dhunshme. Në mungesë të një analize të tillë nga Dhoma Gjyqësore dhe duke marrë parasysh rrethanat e kësaj çështjeje, Dhoma e Apelit gjykon se pavarësisht nga mosmarrja e masave të përshtatshme nga Z. Llazareviq për kallëzimin, hetimin dhe nisjen e procedimit disiplinor, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të konkludonte jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se një mospërbushje e tillë e detyrës në këtë aspekt ndikoi thelbësisht në kryerjen e shpërnguljes së dhunshme. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon të gabuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore se z. Llazareviq ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e shpërnguljes së dhunshme nëpërmjet mosmarrjes prej tij të masave të përshtatshme që do të mundësonin hetimin e duhur të krimeve të rënda të kryera nga forcat e UJ-së.

Më tej, z. Llazareviq kundërshton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se inspektimi prej tij i njërive të UJ-së ofroi inkurajim dhe mbështetje morale për forcat e UJ-së të angazhuara në shpërngulje të dhunshme. Dhoma e Apelit kujton se inkurajimi dhe mbështetja morale përbëjnë kontribut të qenësishëm në një krim vetëm në rastin kur autorët kryesorë të krimit janë të vetëdijshëm për të. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se i vetmi deduksion logjik që mund të nxirrej ishte se inspektimi i njërive të Korpusit të Prishtinës prej z. Llazareviq u ofroi inkurajim dhe mbështetje morale autorëve të krimit. Rrjedhimisht, në lidhje me këtë aspekt, sjellja e z.

Llazareviq nuk mund të cilësohet ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme nga forcat e UJ-së.

Gjithsesi, Dhoma e Apelit gjykon se gabimet e konstatuara nuk çenojnë konkluzionet përfundimtare të Dhomës Gjyqësore se z. Lazareviq u dha praktikisht ndihmë pjesëtarëve të UJ-së të implikuar në kryerjen e zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit dhe se kjo ndihmë ndikoi thelbësisht në kryerjen e këtyre krimeve. Dhoma e Apelit kujton se Dhoma Gjyqësore konkludoi se z. Lazareviq mori pjesë në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta të kryera nga UJ-ja dhe në këtë mënyrë kontribuoi thelbësisht në kryerjen e krimeve nga UJ-ja, duke qenë se një sjellje e tillë ofroi ndihmë nëpërmjet dislokimit të ushtarëve në terren për kryerjen e veprimeve përkatëse, organizimit dhe furnizimit me pajisje të njësisve të UJ-së dhe furnizimit me armë ndër të cilat tanke në mbështetje të këtyre veprimeve.

Në vijim, z. Lazareviq argumenton se është i gabuar përfundimi i Dhomës Gjyqësore se ai kishte synimin e nevojshëm kriminal për ndihmë dhe inkurajim të dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme kryer nga UJ-ja. Z. Lazareviq parashtrohet se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se bazuar në dijeninë e tij për ngjarjet dhe krimet më 1998, ai ishte i vetëdijshëm se kishte të ngjarë të ndodhnin përdorim i forcës së tepruar dhe shpërngulje e dhunshme në rast se ai urdhëronte UJ-në që të vepronte në Kosovë më 1999. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se më 1998 kishte ndodhur shpërngulje e dhunshme. Informacioni i marrë nga z. Lazareviq më 1998 më së shumti e bëri të vetëdijshëm për gjasën e përdorimit të forcës së tepruar apo pa dallim ose të kryerjes së krimeve të tjera në Kosovë nga forcat e UJ-së në rast se do të urdhëroheshin të vepronin në Kosovë më 1999. Mirëpo Dhoma e Apelit gjykon se vetëm kjo dijeni nuk është e mjaftueshme që një gjykues i arsyeshëm faktesh të konkludonte se i vetmi deduksion logjik mbetej që z. Lazareviq të ishte i vetëdijshëm për gjasën e shpërnguljes së dhunshme në rast se ai do të urdhëronte UJ-në të vepronte në Kosovë më 1999. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gaboi në këtë pikë.

Gjithsesi, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim Dhoma e Apelit konkludon se një gjykues i arsyeshëm faktesh do të kishte konkluduar se i vetmi deduksion logjik që mund të nxirret prej provave është se që nga 24 marsi 1999 kur në Prishtinë ndodhën krimet e para, z. Lazareviq ishte në dijeni të fushatës së terrorit, dhunës dhe shpërnguljes së dhunshme të ndërmarrë nga forcat e UJ-së dhe MPB-së kundër popullatës shqiptare kosovare. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rrëzon pjesët përkatëse të apelit të z. Lazareviq.

Për këtë arsye Dhoma e Apelit lë në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se z. Lazareviq ndihmoi dhe inkurajoi në dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).

Apeli i Prokurorisë në lidhje me z. Lazareviq

Tani do të shqyrtohet apeli i Prokurorisë në lidhje me lirimin e z. Lazareviq prej akuzave për vrasje si krim kundër njerëzimit, vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe përndjekje nëpërmjet vrasjes si krim kundër njerëzimit.

Dhoma Gjyqësore konkludoi se fushata e organizuar e UJ-së dhe MPB-së nuk kishte si objektiv vrasjet. Për këtë arsye, megjithëse konkludoi se z. Lazareviq ishte në dijeni të vrasjes së shqiptarëve kosovarë nga forcat e UJ-së në disa raste, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ai nuk ishte në dijeni se forcat e UJ-së dhe të MPB-së shkuan në vende konkrete krimi për të kryer vrasje.

Prokuroria argumenton se duke e liruar zotin Lazareviq prej akuzës për ndihmë dhe inkurajim të vrasjeve, Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor në lidhje me standardin e synimit kriminal të ndihmës dhe inkurajimit. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore zbatoi një standard që kushtëzonte që z. Lazareviq të ishte i vetëdijshëm për elementët thelbësorë të

krimit konkret të kryer, përfshirë gjendjen mendore të autorëve të krimit. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit bindet se Dhoma Gjyqësore përdori standardin e duhur ligjor.

Ndryshe, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktik duke e liruar zotin Llazareviq prej akuzës për ndihmë dhe inkurajim në vrasje. Gjithsesi, Dhoma e Apelit gjykon se Prokuroria nuk ka mundur të provojë gabim në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se z. Llazareviq nuk kishte synimin e nevojshëm kriminal. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rrëzon pjesën përkatëse të apelit të Prokurorisë dhe lë në fuqi pafajësinë e zotit Llazareviq për ndihmë dhe inkurajim të vrasjeve.

Dënimet

Tani do të diskutoj dënimet. Si apeluesit, po ashtu edhe Prokuroria i kanë apeluar dënimet e dhëna nga Dhoma Gjyqësore.

Pasi ka shqyrtuar me vëmendje argumentet e palëve, Dhoma e Apelit konstaton pika të vlefshme në argumentet e Prokurorisë, të z. Shainoviç dhe të z. Llukiç se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të individualizonte dënimet si dhe në argumentin e z. Llukiç lidhur me cilësimin si rrethanë lehtësuese të dorëzimit të tij. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton pjesët përkatëse të apelit të Prokurorisë, të apelit të z. Shainoviç dhe të apelit të z. Llukiç. Dhoma e Apelit i rrëzon të gjitha pikat e tjera të apeleve të apeluesve dhe të Prokurorisë lidhur me dënimet.

Tani është momenti të analizoj ndikimin e përfundimeve të Dhomës së Apelit ndaj dënimeve. Në këtë kontekst Dhoma e Apelit kujton se veç përfundimeve të veta lidhur me apelet e palëve kundër dënimeve, Dhoma shfuqizoi disa verdikte fajësie në lidhje me çdo apelues. Duke u bazuar në rrethanat e kësaj çështjeje si dhe në peshën e krimeve për të cilat apeluesit janë fajtorë, si dhe duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, Dhoma e Apelit gjykon se në lidhje me z. Shainoviç, z. Llazareviq dhe z. Llukiç, është e përligjur një ulje e kufizuar e dënimit.

Vendim

Tani do të lexoj tekstin e plotë të vendimit të Dhomës së Apelit.

Për arsyet e lartpërmendura, **DHOMA E APELIT**,

BAZUAR NË Nenin 25 të Statutit dhe rregullën 117 dhe Rregullën 188 të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimet përkatëse me shkrim të palëve dhe argumentet e paraqitura prej tyre në seancën e apelit më 11-15 mars 2013;

MBLEDHUR në seancë publike

Z. Shainoviç, ju lutem ngrihuni.

NË LIDHJE ME NIKOLLA SHAINOVIQIN,

MIRATON pjesërisht pikën e katërt të apelit të Shainoviçit dhe **SHFUQIZON** fajësinë e tij për vrasje nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK, si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe për vrasje dhe përndjekje nëpërmjet vrasjes si krime kundër njerëzimit në Bellacërkë, Krushë të Vogël, qytetin e Suharekës, Izbicë, qytetin e Gjakovës, Korenicë dhe Mejë, dhe afër Studimes së Epërme (pjesërisht Pika 3, pjesërisht Pika 4, dhe pjesërisht Pika 5);

MIRATON nën pikën 7(3) të apelit të Shainoviçit lidhur me dënimin;

Me përjashtim të mospajtit të gjykatësit Liu dhe gjykatësit Tuzmukhamedov, **RRËZON** të gjitha pikat e tjera të apelit të Shainoviçit;

SHFUQIZON *proprio motu* fajësinë e Shainoviqit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Tushilë (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2);

SHFUQIZON fajësinë e Shainoviqit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Turiqec (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2), si rrjedhojë e miratimit të pjesshëm të nënpikës 1(f) të apelit të Llazareviciqit;

Me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Liu dhe gjykatësit Tuzmukhamedov **LË NË FUQI** verdiktet e tjera të fajësisë së Shainoviqit në Pikat 1 - 5;

Me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Liu dhe gjykatësit Tuzmukhamedov, **MIRATON** pjesërisht pikën e tretë dhe pikën e katërt të apelit të Prokurorisë dhe me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Liu dhe gjykatësit Tuzmukhamedov, **KONKLUDON** se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Shainoviqin të pafajshëm për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK si krim kundër njerëzimit në Beleg, Qirez, dhe Prishtinë (pjesërisht Pika 5), mirëpo me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatëses Ramaroson **REFUZON** të japë verdikte të reja fajësie kundër tij lidhur me këtë pikë;

MIRATON pjesërisht pikën e gjashtë të apelit të Prokurorisë lidhur me dënimet;

RRËZON apelin e Prokurorisë në të gjitha aspektet e tjera lidhur me Shainoviqin;

ANULON dënimin me 22 vjet burgim dhe **URDHËRON** një dënim me XX vjet burgim, duke llogaritur brenda kohëzgjatjes së dënimit, kohën që ai ka qenë në paraburgim, në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores;

Z. Shainoviq mund të uleni.

Z. Pavkoviç, ju lutem ngrihuni.

NË LIDHJE ME NEBOJSHA PAVKOVICIN,

RRËZON tërësisht apelin e Pavkoviçit;

SHFUQIZON *proprio motu* fajësinë e Pavkoviçit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Tushilë (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2);

SHFUQIZON fajësinë e Pavkoviçit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Turiqec (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2), si rrjedhojë e miratimit të pjesshëm të nënpikës 1(f) të apelit të Llazareviciqit;

SHFUQIZON fajësinë e Pavkoviçit si pjesëmarrës në NPK për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe vrasje e përndjekje nëpërmjet vrasjeve si krime kundër njerëzimit në lidhje me 274 nga 287 shqiptarë kosovarë të vrarë në Korenicë dhe Mejë dhe rrethinat e tyre gjatë operacionit të luginës së Carragojit (pjesërisht Pika 3, pjesërisht Pika 4, dhe pjesërisht Pika 5), si pasojë e miratimit të pjesshëm të pikës Q të apelit të Llukiçit;

LË NË FUQI verdiktet e tjera të fajësisë së Pavkoviçit në Pikat 1 - 5;

MIRATON pjesërisht pikën e katërt të apelit të Prokurorisë dhe **KONKLUDON** se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Pavkoviçin të pafajshëm për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK si krim kundër njerëzimit në Prishtinë (pjesërisht Pika 5), mirëpo me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatëses Ramaroson, **REFUZON** të japë verdikte të reja fajësie kundër tij lidhur me këtë pikë;

MIRATON pjesërisht pikën e gjashtë të apelit të Prokurorisë lidhur me dënimet;

RRËZON apelin e Prokurorisë në të gjitha aspektet e tjera lidhur me Pavkoviçin;

LË NË FUQI dënimin me 22 vjet burgim, duke llogaritur brenda kohëzgjatjes së dënimit kohën që ai ka qenë në paraburgim, në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores;

Z. Pavkoviç, mund të uleni.

Z. Llazareviç, ju lutem ngrihuni.

NË LIDHJE ME VLADIMIR LLAZAREVIQIN,

MIRATON pjesërisht nënpikën 1(f) dhe nënpikën 1(i) të apelit të Llazareviçit dhe SHFUQIZON fajësinë e tij si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Turqeci dhe në qytetin e Kaçanikut (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2);

MIRATON pjesërisht nënpikën 3(e), nënpikën 3(h), dhe nënpikën 3(i) të apelit të Llazareviçit dhe RRËZON përfundimet e Dhomës Gjyqësore se: (i) mosmarrja prej tij e masave të përshtatshme hetimore dhe ndëshkimore, kontribuoi thelbësisht në kryerjen e zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit nga forcat e UJ-së; dhe (ii) inspektimi prej tij i njësive të UJ-së inkurajoi dhe u dha mbështetje morale forcave të UJ-së të angazhuara në shpërnguljen e dhunshme;

RRËZON apelin e Llazareviçit në lidhje me të gjitha aspektet e tjera;

SHFUQIZON *proprio motu* fajësinë e Llazareviçit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Tushilë (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2);

LË NË FUQI verdiktet e tjera të fajësisë së Llazareviçit në Pikat 1 - 2;

MIRATON pjesërisht pikën e pestë të apelit të Prokurorisë dhe KONKLUDON se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Llazareviçin të pafajshëm për ndihmë dhe inkurajim në dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Zhabar, Dushanovë, Sojevë, Fshat të Vjetër dhe Mirosalë (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2), mirëpo me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatëses Ramarason, REFUZON të japë verdikte të reja fajësie kundër tij lidhur me këtë pikë;

MIRATON pjesërisht pikën e gjashtë të apelit të Prokurorisë lidhur me dënimet;

RRËZON apelin e Prokurorisë në të gjitha aspektet e tjera lidhur me Llazareviçin;

ANULON dënimin me 15 vjet burgim dhe URDHËRON një dënim me XX vjet burgim, duke llogaritur brenda kohëzgjatjes së dënimit kohën që ai ka qenë në paraburgim, në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores;

Z. Llazareviç, mund të uleni.

Z. Llukiq, ju lutem ngrihuni.

NË LIDHJE ME SRETEN LLUKIQIN,

MIRATON pjesërisht nënpikën O(1)(e) dhe pikën Q të apelit të Llukiqit dhe SHFUQIZON fajësinë e Llukiqit si pjesëmarrës në NPK për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe vrasje e përndjekje nëpërmjet vrasjeve si krime kundër njerëzimit të kryera në Bellacërkë, Krushë të Vogël, qytetin e Suharekës, Izbicë dhe në qytetin e Gjakovës si edhe në lidhje me 274 nga 287 shqiptarë kosovarë të vrarë në Korenicë dhe Mejë dhe rrethinat e

tyre gjatë operacionit të luginës së Carragojit (pjesërisht Pika 3, pjesërisht Pika 4, dhe pjesërisht Pika 5);

MIRATON pjesërisht nënpikën KK(3) dhe nënpikën KK(1) të apelit të Llukiqit lidhur me dënimin;

RRËZON apelin e Llukiqit në lidhje me të gjitha aspektet e tjera;

SHFUQIZON *proprio motu* fajësinë e Llukiqit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Tushilë (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2);

SHFUQIZON fajësinë e Llukiqit si pjesëmarrës në NPK për dëbim dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit të kryera në Turiqec (pjesërisht Pika 1 dhe pjesërisht Pika 2), si rrjedhojë e miratimit të pjesshëm të nënpikës 1(f) të apelit të Llazareviqit;

LË NË FUQI verdiktet e tjera të fajësisë së Llukiqit në Pikat 1 - 5;

MIRATON pjesërisht pikën e tretë dhe pikën e katërt të apelit të Prokurorisë dhe **KONKLUKON** se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Llukiqin të pafajshëm për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK si krim kundër njerëzimit në Beleg, Qirez, dhe Prishtinë (pjesërisht Pika 5), mirëpo me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatëses Ramaroson, **REFUZON** të japë verdikte të reja fajësie kundër tij lidhur me këtë pikë;

MIRATON pjesërisht pikën e gjashtë të apelit të Prokurorisë lidhur me dënimet;

RRËZON apelin e Prokurorisë në të gjitha aspektet e tjera lidhur me Llukiqin;

ANULON dënimin me 22 vjet burgim dhe **JEP** një dënim me XX vjet burgim, duke llogaritur brenda kohëzgjatjes së dënimin, kohën që ai ka qenë në paraburgim, në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores;

VENDOS që ky Aktgjykim të zbatohet menjëherë në bazë të Rregullës 118 të Rregullores;

Në përputhje me Rregullën 103(C) dhe Rregullën 107 të Rregullores **URDHËRON** që apeluesit të mbahen në paraburgim prej Tribunalit deri në finalizimin e masave për transferimin e tyre në shtetin ku do të vuajnë dënimin.

Gjykatësi Judge Liu Daqun bashkëngjit mendim pjesërisht mospajtues dhe një deklaratë.

Gjykatësja Arlette Ramaroson bashkëngjit mendim mospajtues.

Gjykatësi Bakhtiyar Tuzmukhamedov bashkëngjit mendim mospajtues.

Pas përfundimit të seancës palëve do t'u jepen kopje të Aktgjykimit.

Deklaroj të mbyllur seancën e Dhomës së Apelit të Tribunalit Penal ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.